

ALBION KADRIU – ADZM TIRANË

Drejt看 i Administratës së Zonave të Mbrojtura Tiranë (ADZM Tiranë).

Z. Albion Kadriu ushtron detyrën e Drejtorit të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Tiranë.

Me formim në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, z. Kadriu është diplomuar në vitin 2010 pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës, ku ka fituar titullin “Inxhinier”. Gjithashtu, është pajisur me titullin “Vlerësues i Pasurive të Paluajtshme”, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Ka përfunduar edhe një Master Profesional në Politikën e Zhvillimit të Territorit, me fokus në Planifikimin Hapësinor dhe aplikimet në GIS.

Karrierën profesionale e ka nisur pas përfundimit të studimeve në struktura të ndryshme në varësi të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, fillimisht në pozicionin e specialistit dhe më pas si përgjegjës sektori. Gjatë eksperiencës së tij profesionale ka ushtruar gjithashtu funksionet e inxhinierit të zbatimit dhe ekspertit të vlerësimit të pasurive të paluajtshme në procese gjyqësore pranë gjykatave të vendit.

Gjatë karrierës së tij, z. Kadriu ka ndjekur trajnime të ndryshme profesionale, përfshirë trajnime në fushën e zonave të mbrojtura, mbrojtjes së natyrës dhe menaxhimit të vlerave natyrore, duke zgjeruar njohuritë dhe kompetencat e tij në funksion të detyrës që ushtron pranë Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Tiranë.